Qendra për Punë Sociale

Është institucion publik profesional në nivel komunal, që ofron shërbime të mbrojtjes sociale për fëmijë dhe të rritur që kanë nevoja sociale pa dallim gjinie, moshe, nacionaliteti apo feje. Qendra për punë sociale ka një personel profesional me kualifikime përkatëse dhe të trajnuar në fushën e shërbimeve sociale dhe merret me mbrojtjen e fëmijëve dhe familjes.

Kontaktoni me Qendrën përPunë Sociale në Pejë:
Telefon: 045 110 887 (24 orë në dispozicion) ose zyrë: 039 433 473 - E-mail: qpspeje@gmail.com

Qendra e Mjekësisë Familjare (QMF)

Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) ekzistojnë në disa lokalitete dhe janë në shërbim të të gjithë pacientëve, mirëpo ekziston edhe Qendrat e Kryesore Mjekësisë Familjare (QKMF) e cila ofron shërbime mjekësore për të gjithë pacientët e komunës. Në këto qendra punojnë mjekët specialistë të përgjithshëm, të cilët trajtojnë probleme të ndryshme shëndetësore. Këto qendra mund t'i kontaktoni ose vizitoni në çdo kohë për të marrë shërbimet shëndetësore gjatë 24 orëve.

Kontakto Qendrën e Mjekësisë Familjare në Pejë,
Shërbimi i Emergjencës: Telefon zyre: 039 432 772 ose e-mail: hekuran.tigani@rks-gov.net
Dr Agron Dreshaj -Pediater Telefon: 045 110 841

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale kujdeset për ofrimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve të mirëfillta shëndetësore si shërbimin e kujdesit parësor shëndetësor, shëndetit publik dhe mirëqenies sociale.
Drejtoria pranon dhe shqyrton kërkesat e ndryshme të qytetarëve për ndihmë momentale dhe ndihma tjera nga fusha e mbrojtjes shëndetësore.

Kontaktoni Drejtorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-Kuvendi Komunal Pejë
Telefon. 044 473 448; e-mail: petrit.loci@rks-gov.net

Shërbimi Sprovues

Shërbimi Sprovues është një shërbim që merret me mbikëqyrjen dhe ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative për personat e mitur (të mitur dhe të rinj) që kanë rënë ndesh me ligjin, si dhe risocializimin dhe re integrimin e tyre në shoqëri. Kjo përfshinë, kryerjen e anketave sociale dhe raporteve para-ndëshkuese, mbikëqyrjen dhe ekzekutimin e masave të diversitetit dhe dhe masave edukuese. Për të ekzekutuar Masat e Diversitetit dhe ato Edukative Shërbimi sprovues duhet të bashkëpunojë me QPS, shkollat, institucionet shëndetësore, policinë dhe institucionet tjera dhe me OJQ-të te cilat kanë programe të ndryshme për fëmijë e të rinjë dhe të cilat ndihmojnë procesin e ri-socializimit dhe ri-integrimit të tyre në shoqëri.

Kontaktoni Shërbimin Sprovues në Pejë
Telefon. 039 432 641.

Drejtoria e Arsimit

Drejtoria e Arsimit bën menaxhimin dhe koordinimin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm në komunë, si dhe inspektimin e shëndetit publik dhe sigurisë. Drejtoria e Arsimit gjithashtu organizon fushata dhe programe për sigurinë në rrugë, nxitjen e shtimit të shëndetit për të shmangur përhapjen e sëmundjeve ngjitëse, si dhe aksione kundër duhanit dhe formave të abuzimit me drogë.

Kontaktoni Drejtorinë e Arsimit në Pejë:
Telefon zyre: 039-431 658.

Njësiti Komunal për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore

Në kuadër të Zyrës komunale për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore ekziston edhe koordinatori për të drejtat e fëmijëve. Ky koordinator për të drejtat e fëmijëve bashkëpunon me Zyrën për barazi gjinore, policinë dhe organet tjera që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve. Kjo zyre trajton të gjitha problematikat që kanë të bëjnë më fëmijët dhe shkeljet e të drejtave të tyre që ju bëhen qoftë në shkollë, shoqëri dhe familje, duke i adresuar të gjitha këto shkelje tek institucionet përkatëse.

Kontaktoni me Zyrën për Barazi gjinore dhe të drejta të njeriut - Kuvendi Komunal Pejë
Telefon: 045 105 781

Save the Children · Syri i Vizionit · Sweden Sverige

"Ky materjal/botim është financuar nga Qeveria e Suedisë. Përgjegjësinë për përmbajtjen e këtij materjali e mban plotësisht hartuesi. Sida nuk ndan medoemos pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura në këtë botim."

INFORMOHU, MBROHU DHE RAPORTO!

Save the Children · Syri i Vizionit · Sweden Sverige

Komuna e Pejës ka hartuar Strategjinë për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Familjes nga Abuzimi dhe një plan pune për implementimin e saj.
Qëllimi i strategjisë është që:
- të parandalohet dhe zvogëlohet dhuna në familje, shkolla dhe ambiente tjera,
- të rritet përgjegjësia institucionale në mbrojtjen e fëmijës dhe familjes nga abuzimi.

Të gjithë fëmijët, pa dallim, gëzojnë të drejtën për përkujdesje, për të qenë të mbrojtur nga të gjitha format e dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit, për të gëzuar një edukim cilësor dhe gjithëpërfshirës, për të pasur qasje në shërbime shëndetësore cilësore dhe mbrojtje të përshtatshme ligjore. Strategjia synon që të mbrojë këto të drejta tuajat.

ÇFARË ËSHTË ABUZIMI?!

ABUZIM I FËMIJËS ËSHTË ÇDO DËMTIM, LËNDIM, TRAJTIM I KEQ, DETYRIM I VAZHDUESHËM PËR TË BËRË GJËRA KUNDËR DËSHIRËS SË FËMIJËS. KËTU PËRFSHIHEN DISA LLOJE TË ABUZIMIT SI: ABUZIMIN FIZIK, EMOCIONAL, EKONOMIK, SEKSUAL SI DHE NEGLIZHENCA.

FORMAT E ABUZIMIT!

Abuzim emocional i fëmijës përkufizohet si një model i sjelljes së vrazhdë dhe jo të pranueshme nga prindërit apo kujdestarët që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin emocional, psikologjik apo social të fëmijës. Llojet e abuzimit emocional ndaj fëmijëve nga ana e prindit apo kujdestarit janë: refuzimi, injorimi, izolimi dhe terrorizimi.

Abuzim fizik është një dëmtim fizik jo aksidental (duke nisur nga mavijosje të lehta në thyerje të rënda apo vdekje), si rrjedhojë e goditjes me shqelma, me grushta e shpulla, shkundja, përplasja, shtyrja, goditja (me dorë, shkop, rrip apo objekte tjera), apo e dëmtimit të fëmijës në forma të tjera. Një dëmtim i tillë konsiderohet abuzim, pavarësisht faktit nëse prindi apo kujdestari i fëmijës ka apo jo qëllim ta dëmtojë fëmijën.

Abuzimi ekonomik përfshin veprime të tilla si kontrolli i të ardhurave të familjes, refuzimi për të kontribuar financiarisht për mbajtjen e familjes, mohimi i nevojave bazë të familjes, etj. Abuzuesi përdor aftësinë financiare për të mbajtur të nënshtruar viktimën.

Abuzim seksual përfshin çdo ekspozim të qëllimshëm të fëmijëve ndaj një aktiviteti seksual, si dhe përdorimi i fëmijëve për qëllime ose kënaqësi seksuale, që ndikon negativisht në zhvillimin normal dhe shëndetësor, si në aspektin emocional ashtu edhe atë fizik..



Neglizhencë konsiderohet mosdhënia e vazhdueshme e kujdesit të përshtatshëm, si psh: streha, ushqimi, veshja, arsimimi, mbikëqyrja, ndihma mjekësore si dhe çdo lloj tjetër ndihme bazë, që është e domosdoshme për zhvillimin e kapaciteteve fizike, intelektuale dhe emocionale të fëmijës ose familjes

KU TË RAPORTOJ DHE TË KËRKOJ NDIHMË?!

Ju mund të raportoni në rast se jeni viktimë e abuzimit, apo nëse keni informata apo dyshoni se ndonjë person është viktimë e abuzimit - qoftë fëmijë apo i rritur.
Institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës dhe familjes nga abuzimi janë:

Policia e Kosovës

Ofron siguri dhe shërbime për të gjithë personat në Kosovë bazuar në ligj, praktikat më të mira dhe standardet e policimit demokratik. Prandaj, për çdo informacion që vlerësoni se mund të jetë me rëndësi për ju, për sigurinë e përgjithshme, apo është e nevojshme të ndërmerren veprime parandaluese apo vepruese nga Policia, ju lutem kontaktoni Policinë e Kosovës.

Kontaktoni Policinë e Kosovës
në çdo kohë në të gjitha rajonet:
Telefon mobil & fiks # 192.
E-mail adresat:info@kosovopolice.com
facebook.com/KosovoPolice
twitter.com/Kosovo_Police